

Data: 04/04/2024

**PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - MALL
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “BLERJE PAISJE PRINTIMI PËR KESH QENDËR DHE NJËSITË
E PRODHIMIT”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): PAJISJE TË
NDRYSHME -39300000-5.**

VLERA E FONDIT LIMIT: 15,000,000 (Pesëmbëdhjetë milion) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

b. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetdeklarimet” dhe Nenit 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar.

Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” citohet: “*Autoriteti Kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”, Në Nenin 82, të LPP

“1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimet, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, i ndryshuar, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke marrë në konsideratë specifikën e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohet që operatori ekonomik ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për tre vitet e fundit financiare të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, i ndryshuar, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat ISO ose ekuivalentet e tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

a) ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”;

b) ISO 27001:2013 “Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit”;

Argumentimi: Kërkesa në lidhje me këto çertifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Janë kërkuar këto çertifikata, që të vërtetojnë se ofertuesit kanë sisteme menaxhimi sipas standardeve ndërkombëtare të cilat reflektojnë dukshëm edhe në cilësinë e shërbimit. Çertifikatat e kërkuara për OE janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore.

ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” - Ky standard është i nevojshëm për çertifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse mallrat e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

ISO 27001:2013 “Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit” – Ky standard është i nevojshëm për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të një sistemi të menaxhimit të sigurisë së informacionit. Ky standard përfshinë kërkesat për vlerësimin dhe trajtimin e rreziqeve të sigurisë të informacionit të përshtatura për nevojat e organizatës, me qëllim që informacioni të mbetet i sigurtë dhe të mos çënohet siguria e sistemeve të saj nga sulmet kibernetike.

Duke qenë se AK KESH është pjesë e infrastrukturës kritike, siguria e informacionit është thelbësore.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij, për periudhën Shkurt 2024 – Mars 2024, një minimum punonjësish të certifikuar për:

- ✚ Jo më pak se 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhuesi për paisjet fotokopje multifunksionale ose institucione certifikuese të autorizuara;
- ✚ Jo më pak se 1 (një) punonjës të certifikuar për rrjetet;
- ✚ Jo më pak se 1 (një) punonjës të certifikuar për platformën Microsoft (Microsoft 365, Server) ose ekuivalent.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

- ✚ Kontratë pune të vlefshme;
- ✚ Çertifikata e mësipërme e vlefshme, e lëshuar nga ent certifikues i akredituar.
- ✚ Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për të paktën Shkurt 2024 – Mars 2024.

Shënim: *Pranohen rastet kur një punonjës disponon më shumë se një certifikatë.*

Argumentimi: Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. KESH sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

Në lidhje me punonjësit, argumentojmë si më poshtë :

✚ Janë kërkuar jo më pak se 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhuesi për paisjet fotokopje multifunksionale ose institucione certifikuese të autorizuara, pasi paisjet fotokopje multifunksionale do të instalohen në KESH Qendër, Njësitë e Prodhimit dhe Magazinën Qëndrore në Shkozet – Durrës. Operatori ekonomik ofertues duhet të garantojë se paisjet që do të ofrojnë duhet të operohen nga specialistë të certifikuar nga prodhuesi ose institucione certifikuese të autorizuara, të cilët kanë aftësi të testuara teknike dhe inxhinierike për instalimin dhe vënien në punë të gjithë paisjeve së bashku me sistemin e menaxhimit, i cili kërkon hapa specifike sipas kërkesave teknike për të kryer mbarëvajtje të mirë menaxhuar të shërbimit në KESH Qendër, Njësitë e Prodhimit dhe Magazinën Qëndrore në Shkozet – Durrës.

✚ Është kërkuar jo më pak se 1 (një) punonjës i certifikuar për rrjetet, pasi për shkak të ndërhyrjes në infrastrukturën KESH, kryesisht në konfigurimet e rrjetit për të shtuar paisjet printera me

adresime IP, nevojitet akomodimi dhe ndarja fizike (virtuale) nga rrjeti ekzistues i kompanisë për shkak të kërkesave në lidhje me sigurinë kibernetike. Kjo ndërhyrje si pasojë e përcaktimit të Korporatës si institucion i infrastrukturës kritike, nevojitet të realizohet me suportin e specialistëve të çertifikuar për rrjetet informatike nga kompani të specializuara të cilët garantojnë cilësinë e punës dhe ruajnë sigurinë e sistemeve të informacionit në infrastrukturën kritike të KESH sh.a.

✚ Është kërkuar jo më pak se 1 (një) punonjës të çertifikuar për platformën Microsoft (Microsoft 365, Server) ose ekuivalent, pasi sistemi i menaxhimit të printimit dhe ndërlidhja me klientët dhe përdoruesit e KESH sh.a, kërkon konfigurime dhe ndërhyrje në direktorinë e përdoruesve të KESH sha, e cila është e ngritur në produkte të Microsoft Active Directory. Ndërhyrja në këto sisteme të cilat afektojnë në mënyrë direkte sigurinë e informacionit përbëjnë një kërkesë kritike për shkak të kërkesave në adaptime. Për këtë arsye nevojitet që punonjësi të jetë i çertifikuar dhe testuar për sisteme server nga Microsoft.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi ose distributor i autorizuar ku të vërtetohet lidhja me prodhuesin, për shitjen e pajisjeve objekt prokurimi.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit.

Argumentimi: Kërkesa për paraqitjen e autorizimeve të prodhuesve ose distributorëve se operatorët ekonomikë janë të autorizuar nga prodhuesi apo distributori i autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.5 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Katalogun/ët teknik dhe broshurat për mallrat që do të furnizojë për këtë objekt prokurimi në mënyrë që të provohet pajtueshmeria me specifikimet teknike.

Në katalog, të markohen në menyrë të qartë dhe të dallueshme mallrat e ofertuara, si edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DT. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike, me qëllim që AK të vlerësojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në DT. Katalogu duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe për mallrat objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa për paraqitjen e katalogut/ëve është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar

nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar, si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të jetë Servis i Autorizuar nga Prodhuesi (i pajisjeve pjesë e shërbimit të kërkuar).

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të mësipërm operatori duhet të paraqesë Kontratën e Servisit të lidhur me prodhuesin.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40 dhe 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Për sa i takon kërkesës për kualifikim se operatori ekonomik duhet të jetë servis i autorizuar nga prodhuesi vjen si rrjedhojë e pajisjeve të cilat kanë nevojë për mirëmbajtje dhe suport. Servisi i Autorizuar i jep sigurinë AK mbi autenticitetin e pjesëve dhe shërbimeve të specializuara.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë se mallrat janë të rinj, të pa përdorur.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, me anë të kësaj deklarate AK krijon bindjen se operatori ekonomik do të përmbush kontratën bazuar në specifikimet dhe kërkesat teknike të kërkuara nga AK, duke garantuar furnizimin me mallra të reja.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Të gjitha dokumentet duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njësimin e dokumenteve.

I. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Bazuar në nevojat aktuale është e domosdoshme paisja e KESH sha, me paisje printimi. Këto paisje do të shpërndahen në të gjitha godinat teknike dhe Administrative të KESH sha. Së bashku me këto paisje është kërkuar të plotësohet nga një set tonera (bojë).

Njësia e Prokurimit